

VENDIM
Nr. 677, datë 22.11.2017

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS, NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE *LOCKHEED MARTIN GLOBAL, INCORPORATED*,
SHBA, PËR BLERJEN E SISTEMIT TË INTEGRUAR TË VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS
AJRORE - FAZA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut III, të rregullores “Për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbimeve të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik”, të miratuar me vendimin nr. 521, datë 8.8.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe *Lockheed Martin Global, Incorporated*, SHBA, për blerjen e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore - Faza I, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KONTRATË

NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE *LOCKHEED MARTIN GLOBAL, INCORPORATED*, SHBA PËR SISTEMI I INTEGRUAR I VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE FAZA I

PARATHËNIE

Kjo Kontratë lidhet në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë:

Ndërmjet:

MINISTRISË SË MBROJTJES

Rruga e Dibrës, 2423

Tiranë, Shqipëri

Tel.: ++355 4 225 5232

Fax: ++355 4 225 5226

Të përfaqësuar zyrtarisht nga:

Znj. Olta Xhaçka

Ministër i Mbrojtjes

- Autoritetit kontraktues (më poshtë referuar si “Furnizuesi”);

dhe

LOCKHEED MARTIN GLOBAL INCORPORATED

PO. Box 4840, Syracuse, NY 13221-4840, USA

Tel.: +1 315 456-2602

Fax: +1 315 456-1321

Të përfaqësuar zyrtarisht nga:

Zoti Christopher Bowman

- Kontraktuesi (më poshtë referuar si “Furnizuesi”).

Tërësia e kësaj Kontrate përbëhet nga “Parathënia”, “Kushtet e Përgjithshme”, “Kushtet e veçanta” dhe “Shtojcat”.

Furnizuesi dhe Blerësi të referuar gjithashtu si “Pala” ose “Palët”, bien dakord si vijon:

Megenëse:

A. Autoriteti kontraktor ka shpallur procedurën e tenderimit për projektin “Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore, faza e I”, me një fond total prej 22.266.000 dollarësh. Me qëllim plotësimin e qëllimit të projektit, fondet e pagueshme nga buxheti i shtetit për Ministrinë e Mbrojtjes do të jenë USD 19.139.000 dhe nga qeveria e SHBA-së do të jenë USD 3.127.000.

B. Më 5.9.2017, me njoftimin e tij me referencë nr. 4908/5, Autoriteti Kontraktor ka deklaruar *Lockheed Martin Global Incorporated* si fitues të tenderit.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj Kontrate (përfshirë shtojcat), termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e specifikuar në këtë seksion:

1.1 “Projekt” nënkupton zbatimin e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore - faza e parë, me vlerë totale prej 22.266.000 USD, me qëllim instalimin dhe pranimin e sistemit në Midë, Pukë. Për qëllimin e zbatimit të këtij projekti do të përfshihen tri Palë, përkatësisht: Ministria e Mbrojtjes, *Lockheed Martin* dhe qeveria e SHBA-së.

1.2 “Kontratë” nënkupton marrëveshjen e nënshkruar midis Blerësit dhe Furnizuesit, duke përfshirë të gjitha nenet në kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, si edhe shtojcat e kësaj Kontrate.

1.3 “Fondet FMS” nënkupton fondet e alokuara për qëllimin e fazës së parë të projektit, nga qeveria amerikane, në përputhje me nenin 13.

1.4 “Blerësi” nënkupton autoritetin kontraktor, Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

1.5 “Furnizuesi” nënkupton kontraktuesin, *Lockheed Martin Global Incorporated*, USA.

1.6 “Mallra” nënkupton mallrat që do të sigurohen nga Furnizuesi te Blerësi sipas kësaj Kontrate.

1.7 “Pajisje” nënkupton radarin TPS-77.

1.8 “Vendndodhja e blerësit” nënkupton vendndodhjen e përcaktuar nga Blerësi për instalimin e pajisjes.

1.9 “Shërbimet” nënkupton të gjithë asistencën teknike dhe të tjera të ofruara nga Furnizuesi, sipas kësaj

Kontrate.

1.10 “Çmimi i Kontratës” nënkupton çmimin që i paguhet Furnizuesit sipas Kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktuale.

1.11 “Kredia dokumentare” nënkupton letërkreditin (LC), e hapur nga Blerësit në një bankë, e cila kryen pagesat në emër të Blerësit në bankën respektive të Furnizuesit.

1.12 “Transferta bankare” nënkupton transaksionet monetare nga llogaria bankare e Blerësit në llogarinë bankare të Furnizuesit.

1.13 “Certifikata e përputhshmërisë” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Organizata e Sigurimit të Cilësisë së Furnizuesit, mbas përfundimit të procedurave të testeve të pranimit në fabrikë, në përputhje me nenin 18, duke vërtetuar përputhshmërinë e mallrave me standardet dhe specifikimet e zbatueshme të prodhuesit.

1.14 “Specifikimet teknike” nënkupton specifikimet që janë përshkruar në shtojcën 1 të Kontratës dhe si ato që shfaqen në matricën e përputhshmërisë në shtojcën 1.

1.15 “Standardet teknike” nënkupton specifikimet e aprovuara nga një strukturë e njohur standardizimi apo standardet teknike të pranuar ndërkombëtarësh. Këto standarde janë të përdorura si rregulla, udhëzues ose përkufizime të karakteristikave që sigurojnë se mallrat janë prodhuar për qëllimin e tyre.

1.16 “Testi i pranimit në fabrikë - FAT” nënkupton testin që do të zhvillohet në ambientet e Furnizuesit që ka për qëllim pranimin e pajisjes në fabrikë.

1.17 “Dorëzimi” nënkupton aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e mallrave në vendin e dorëzimit sikurse specifikohet në Kontratë.

1.18 “Certifikata e pranimit në fabrikë” nënkupton certifikatën e firmosur nga Palët, pas përfundimit të testeve të kërkuara në fabrikë.

1.19 “Testi i pranimit në vendndodhje - SAT” nënkupton testin që do të zhvillohet në vendndodhjen e instalimit të radarit të Blerësit, që ka për qëllim pranimin e pajisjes në vendndodhjen.

1.20 “Certifikata e pranimit në vendndodhje” nënkupton certifikatën e firmosur nga Palët, pas përfundimit të testit në vendndodhje.

1.21 “Certifikata e përmbushjes së fazës” ose “COMA” nënkupton dokumentin e firmosur nga Palët, që vërteton se faza e përmbushur është në përputhshmëri me Kontratën e nënshkruar.

1.22 “Certifikata e përfundimit të shërbimit” nënkupton dokumentin e firmosur nga Blerësi, i cili verifikon që shërbimet e realizuara janë në përputhshmëri me Kontratën e nënshkruar.

1.23 “Origjina e mallit” nënkupton vendin ku janë prodhuar mallrat.

1.24 “Formulari EUC” nënkupton certifikatën e përdoruesit të fundit të lëshuar nga autoritetet e përdoruesit të fundit për mallrat që deklarohen qëllimin dhe përdorimin e mallit për qeverinë amerikane, *Formulary DSP-83*.

1.25 “Datë e hyrjes në fuqi të Kontratës” nënkupton kur Kontrata hyn në fuqi siç përcaktohet në nenin 30 të kësaj Kontrate.

1.26 “Performanca e Kontratës” nënkupton zbatimin e termave kontraktuale të rënë dakord nga Palët.

1.27 “Ditë” nënkupton ditët kalendarike.

1.28 “Koha zero - T0” nënkupton datën kur fillon plani i livrimit siç përcaktohet në nenin 30 të kësaj Kontrate.

1.29 “Blok pajisjeje (LRU)” nënkupton një komponent modular të sistemit që është i dizenuar të zëvendësohet shpejt, në vendndodhjen e radarit.

Neni 2

Qëllimi i Kontratës

Qëllimi i Kontratës është pajisja e forcës ajrore me sistemin e integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore (faza I), sipas shtojcës 9 dhe të përshkruar në shtojcën 1, “Qëllimi i punës”.

Blerësi ra dakord të blejë nga Furnizuesi dhe Furnizuesi të bjerë dakord t’i shesë Blerësit një radar TPS-77 të vëzhgimit të hapësirës ajrore dhe elementet shoqëruese ndihmëse (sistemi TPS-77), sipas qëllimit të punës, në përputhje të këtyre termave dhe kushteve.

Neni 3

Pronësia

3.1 Pronësia e mallrave

Të gjitha të drejtat e pronësisë, të siguruara nga Furnizuesi gjatë zbatimit të Kontratës, do t’i përkasin Blerësit, i cili mund t’i përdorë ato siç e sheh të përshtatshme, në përputhje me EUC-formular.

3.2 Furnizuesi do t'i paraqesë Blerësit paketën e të dhënave të *interface*-it dhe manualin e përdoruesit të mbledhura ose të përgatitura nga Furnizuesi gjatë zbatimit të Kontratës.

3.3 Pronësia intelektuale

Në varësi të ndonjë të drejte të Palëve të treta, Furnizuesi do të mbajë të gjitha të drejtat e të dhënave, programit, dizenjimeve, njohurive, patentave, të fshehtave tregtare dhe të drejtat e autorit në lidhje me mallrat.

Nëse Furnizuesi nuk bie dakord me shkrim, Blerësi nuk do të lejohet në asnjë rrethanë të përshtatë, të riprodhojë dhe të modifikojë të gjitha ose një pjesë të mallrave ose të dokumentacionit ose të të dhënave në lidhje me mallrat ose të kryejë analiza inxhinierike të mallrave, nëse kjo është e mundur.

Furnizuesi i jep Blerësit një licencë joekskluzive, jo të transferueshme, për të përdorur ndonjë program në formën e kodit të objektit në kompjuter/a ose sistem/e për të cilat është siguruar. Më tej, Blerësi mund të përdorë dokumentacionin e Furnizuesit.

Nëse ka ndonjë pretendim ose padi kundër Blerësit, në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale, të shkaktuar gjatë zbatimit të Kontratës ose gjatë përdorimit të mallrave, furnizuar në përputhje me Kontratën, Furnizuesi duhet t'i sigurojë ndihmë Blerësit në mbrojtjen kundër padisë apo pretendimit.

Neni 4

Ligji i zbatueshëm

Kontrata do të interpretohet sipas ligjit zviceran. Palët do të pajtohen me ligjet dhe rregullat e SHBA-së ose të Shqipërisë, varësisht nga vendndodhja e performancës. Konventa e Kombeve të Bashkuara "Mbi kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave" nuk aplikohet për zbatimin ose interpretimin e kësaj Kontrate.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

5.1 Palët do të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë Kontratë, me negociata direkte.

5.2 Nëse 2 (dy) muaj pas paraqitjes së një mosmarrëveshjeje kundërshtie ose pretendimi të tillë, Palët dështojnë të arrijnë një marrëveshje, atëherë mosmarrëveshja, kontradikta ose pretendimi do të zgjidhet sipas "Rregullores së konsultimit dhe arbitrazhit" të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga tre arbitra të emëruar në përputhje me rregullat e përmendura.

5.3 Palët bien dakord që të zgjidhin përfundimisht mosmarrëveshjen në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Vjenë, Austri. Mosmarrëveshja do të zgjidhet nga një ose më shumë arbitra të caktuar, në përputhje me rregullat në fjalë, përveç rasteve kur Palët bien dakord mbi emrin e një arbitri të vetëm. Vendimi i arbitrazhit do të jetë përfundimtar, detyrues dhe i zbatueshëm për Palët. Procedura e arbitrazhit do të mbahet në gjuhën angleze.

5.4 Do të garantohet mbrojtja e imunitetit sovran të shtetit shqiptar, duke përjashtuar rastet e mëposhtme nga ekzekutimi i vendimeve të ndryshme të gjykatave, sipas përmbajtjes së mëposhtme:

a) "Ambientet e misionit", të tashme apo të ardhme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës "Mbi marrëdhëniet diplomatike", të nënshkruar në vitin 1961; "Ambiente konsullore" të tashme apo të ardhme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës "Për marrëdhëniet konsullore", të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoren nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë, ose çdo agjenci ose instrument i tyre.

b) Asnjë pasuri e paluajtshme sipas nenit 3, paragrafi 1–3, i ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar.

c) Asnjë fond monetar ose shuma monetare të përcaktuara për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka në bazë të traktateve, konventave apo marrëveshjeve publike ndërkombëtare të nënshkruara në kapacitetin e saj si subjekt i së drejtës ndërkombëtare publike.

Neni 6

Tërësia e Kontratës dhe ndryshimet

6.1 Kushtet e përgjithshme të Kontratës, së bashku me kushtet e veçanta të Kontratës të përmbajtura dhe të pranura shprehimisht në këtë Kontratë, përbëjnë tërësinë e Kontratës midis Furnizuesit dhe Blerësit. Ato zëvendësojnë të gjitha komunikimet ose marrëveshjet e mëparshme, të shkruara ose verbale, midis Furnizuesit dhe Blerësit në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

6.2 Në rast se një ose më shumë klauzola të parashikuara në këtë Kontratë vlerësohen si të pavlefshme

apo të pazbatueshme, dispozitat që mbeten do të qëndrojnë plotësisht të vlefshme dhe të zbatueshme. Dispozitat e pavlefshme do të zëvendësohen me miratim të shkruar nga të dyja Palët, nga dispozita që përmbushin në masën që është e mundur qëllimin ligjor dhe ekonomik të dispozitave të konsideruara si të pavlefshme ose të pazbatueshme.

Neni 7

Konfidencialiteti

7.1 Secila Palë do të ruajë konfidencialitetin dhe nuk do të përdorë apo t'i zbulojë një Palë të tretë, pa lejen paraprake me shkrim të Palës tjetër, asnjë të dhënë ose informacion të Palës tjetër që identifikohet si "Pronësi" ose "Konfidencial".

7.2 Detyrimi në fjalinë e mësipërme nuk do të zbatohet për të dhënat ose informacionin që në kohën e zbulimit ishte ose që më pas bëhet publik, ishte në posedim të Palës që merr një informacion të tillë para se ta marrë atë nga Pala tjetër, ose që disponohet ligjërisht nga Pala marrëse.

Neni 8

Nënkontraktimi

8.1 Furnizuesi nuk do të transferojë detyrimet e tij sipas Kontratës, plotësisht ose pjesërisht, përveçse kur është marrë vendimi paraprak i Blerësit.

8.2 Nënkontraktimi do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës Furnizuesi i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të Kontratës së tij një palë të tretë. Furnizuesi nuk do të nënkontrakttojë më shumë se 40% të vlerës së Kontratës. Deri në nënshkrimin e Kontratës, Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit një marrëveshje paraprake me nënkontraktuesin për elementet e Kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit.

8.3 Furnizuesi mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e Kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit. Pagesa të drejtpërdrejta te nënkontraktori nuk do të lejohen.

Neni 9

Gjuha e Kontratës dhe shkëmbimi i informacionit

9.1 Kontrata është shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Në rast mosmarrëveshjeje midis Palëve do të mbizotërojnë versionin anglisht.

9.2 Komunikimi, korrespondenca, raportet ndërmjet Palëve do të jenë në gjuhën angleze, sipas adresave të mëposhtme. Palët do të konfirmojnë marrjen e njoftimit.

Neni 10

Korrespondenca

10.1 Adresat zyrtare për komunikim midis Palëve

Të gjitha komunikimet do t'u drejtohen:

FURNIZUESIT:

Në adresën e mëposhtme:

Lockheed Martin Global, Incorporated

P.O. Box 4840

Syracuse, NY 13221-4840

Bldg. EP5 Room 201

Menaxheri i Kontratës

Zoti Chris Bowman

Telephone: +1 315 456-2602

Fax: +1 315 456-1321

Email: chris.e.bowman@lmco.com

BLERËSIT:

Në adresën e mëposhtme:

MINISTRIA E MBROJTJES

Drejtoria e Standardeve dhe Modernizimit

Rruga e Dibrës, 2423

Tirana, Albania

MENAXHERIT TË PROGRAMIT TË BLERËSIT:

Drejtoria e Standardeve dhe Modernizimit
Telephone : + 355 4 225 52 32
Fax : + 355 4 222 52 27
Email : lindita.bardhoshi@mbrojtja.gov.al
hilaledia@mbrojtja.gov.al

10.2 Pikat e tjera të kontaktit, në interes të zbatimit të kësaj Kontrate, do të komunikohen nga Drejtoria e Standardeve dhe Modernizimit.

10.3 Çdo Palë do të lajmërojë menjëherë Palën tjetër për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesve të asaj Pale. Nëse njëra nga Palët dështon të lajmërojë, do të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

10.4 Çdo njoftim i transmetuar në lidhje me Kontratën do të jetë efektive kur të merret me shkrim në adresën e mësipërme. Njoftimet mund të dërgohen ose transmetohen me çdo mjet të besueshëm dhe që mund të pranohen në kohë nga Pala tjetër, duke përfshirë, pa kufizim, nëpërmjet postës elektronike, faksit ose shërbimit të shpejtë të postimit.

Neni 11

Origjina e mallrave

11.1 Origjina e mallrave është ajo e përcaktuar në këtë Kontratë. Në raste të justifikueshme, origjina e mallit mund të ndryshojë vetëm me autorizimin paraprak me shkrim të Blerësit.

11.2 Blerësi ka të drejtë të verifikojë origjinën e mallrave, pjesë e kësaj Kontrate.

Neni 12

Licenca/autorizime për eksport/import

12.1 Kontrata dhe të gjitha detyrimet e Palëve u nënshtrohen të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të eksportit dhe importit të Shteteve të Bashkuara, të Shqipërisë ose të vendeve të tjera që aplikojnë ligje dhe rregullore eksporti dhe importi dhe secila Palë do të veprojë në përputhje të plotë me të gjitha ligjet dhe rregulloret që mund të aplikohen për sistemin TPS-77.

12.2 Në masën që ndalohen nga Shtetet e Bashkuara ose ligjet e eksportit të vendit të aplikueshëm, ndonjë nga të dhënat teknike që ka të bëjë me sistemin TPS-77, të furnizuar sipas kësaj Kontrate dhe/ose çdo marrëveshje teknike asistence ndërmjet Palëve dhe/ose ndonjë dispozitë trajnimi, të parashikuar në Kontratë ose që rrjedh prej saj, duke përfshirë edhe ndryshimet e saj, që kanë të bëjnë me sistemin TPS-77, nuk janë të autorizuar për t'u shitur, për t'u dhënë me qira, për t'u ridhënë me qira, për t'u caktuar, për t'u transferuar, për t'u transmetuar ose për t'u publikuar në ndonjë mënyrë tjetër në ndonjë vend tjetër ose shtetas të huaj jashtë destinacionit të synuar sipas kësaj Kontrate, pa pëlqimin paraprak të Furnizuesit.

12.3 Furnizuesi do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të marrë çdo autorizim të nevojshëm për eksportin e pajisjeve, duke përfshirë çdo leje eksporti ose autorizim tjetër të qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose të ndonjë vendi tjetër të aplikueshëm. Blerësi dhe Furnizuesi do të ndihmojnë njëri-tjetrin në sigurimin dhe respektimin e këtyre autorizimeve. Në rast se autorizimi i eksportit nuk mund të merret, pajisja, e cila nuk mund të eksportohet, nuk do të dorëzohet dhe do të bëhet rregullimi i barabartë i çmimit.

KUSHTET E VEÇANTA

Neni 13

Çmimi i projektit dhe i Kontratës

13.1 Çmimi i projektit është USD 22.266.000 (njëzet e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë USD), pa TVSH. Çmimi i Kontratës përfshin të gjitha kostot dhe tarifatat e Furnizuesit, detyrimet e tij doganore, taksat dhe pagesa të tjera në vendin e Shitësit, që lidhen me dorëzimin e mallrave/pajisjeve, pagesën për transportin, siguracionin, testimin, ngarkimin, udhëzimet, manualët dhe dokumentet në gjuhën e specifikuar dhe të kërkuar për përdorim normal. Çmimi i projektit është i ndarë në çmimin e Kontratës më poshtë dhe financimin FMS. Vlera e Kontratës mbetet fikse për të gjithë fazën e zbatimit të Kontratës. Kjo nuk mund të rritet ose të ulet, përveç ndryshimeve të rëna dakord nga Palët. Çmimi është i detajuar si më poshtë:

Nr.	Zëri	Sasia	Çmimi për njësi	ÇMIMI TOTAL
Çmimi i Kontratës				
1	Radar TPS-77 Full Size	1	\$16,427,000	\$16,427,000
2	Tower with Concrete Pad	1	\$1,477,000	\$1,477,000
3	Dual Diesel engine generator enclosed under radar platform with fuel tank underground and Automatic Switch over	1	\$270,000	\$270,000
4	Site UPS	1	\$250,000	\$250,000
5	Building	1	NSP Included with Tower	NSP Included with Tower
6	Redundant Microwave links to MCC	1	\$715,000	\$715,000
Fondet FMS (2019)				
7	TPS-77 Operator and Familiarization training	1	\$ 90,000	\$ 90,000
8	Transportation & Installation	1	\$1,492,000	\$1,492,000
9	Radome Installation	1	\$ 991,000	\$ 991,000
10	MCS Installation	1	\$ 320,000	\$ 320,000
11	Voice Communications	1	\$ 234,000	\$ 234,000
Çmimi i Kontratës (Fondet e MM-së)				\$ 19,139,000
Fondet FMS				\$ 3,127,000
VLERA TOTALE E PROJEKTIT				\$ 22,266,000

13.2 Çmimi i Kontratës është në përputhje me incotermin e përcaktuar në nenin 15.1, që përfshin të gjitha shpenzimet, kostot, taksat dhe detyrimet që lidhen me prodhimin, testimet, eksportin, ngarkimin në portin e importit. Çmimi është në përputhje me sasinë dhe specifikimin e mallit të përshkruar në shtojcën 1.

13.3 Fazat 7 deri 11, me vlerë prej \$ 3.127.000 (tre milionë e njëqind e njëzet e shtatë) do të kryhen dhe do të paguhën nëpërmjet një Kontrate FMS, në përputhje me rregullat e SHBA-së. Blerësi do të punojë me qeverinë e SHBA-së për të përcaktuar një letërofertë dhe pranimi (LOA) për këtë qëllim, në përputhje me shtojcën 4 “Letërkërkesë”. Furnizuesi do të punojë me qeverinë e SHBA-së për të negociuar dhe për të nënshkruar Kontratën FMS, bazuar në LOA-në e sipërpërmendur për realizimin e këtij qëllimi.

13.4 Çmimi i Kontratës është në monedhën USD, në llogaritje dhe pagesa.

13.5 Çmimi u referohet mallrave/pajisjeve të parashikuara në mënyrë të shprehur në këtë Kontratë. Çdo ndryshim konfigurimi dhe/ose çdo mall shtesë që duhet të sigurohet nga Furnizuesi, duhet që më parë të jetë bërë me marrëveshje me shkrim dhe duhet të jetë subjekt i një amendimi të Kontratës, duke përcaktuar çdo ndryshim në çmim dhe/ose në planin e dorëzimit.

Neni 14

Kushtet e pagesës

14.1 Të përgjithshme

i) TVSH-ja dhe taksat e tjera të aplikueshme në vendin e Blerësit, në zbatim të ligjeve të brendshme, do të paguhën nga Blerësi.

Në rastin kur Furnizuesi konsiderohet nga ligji shqiptar si taksapagues, përgjegjës për taksat e sipërpërmendura, Blerësi do t'i paguajë ato taksa për Furnizuesin ose, nëse nuk është e mundur, do të rimbursojë Furnizuesin. Taksat e jetesës, nëse ka, për personelin e Furnizuesit, nuk do të paguhën nga Blerësi.

ii) Në këtë Kontratë do të aplikohen: parapagesa dhe pagesa e progresit të punës sipas nenit 14.2; dhe pagesat e fazave sipas nenit 14.3.

iii) Parapagesa dhe pagesa e progresit të punës do të kryhen nëpërmjet transfertës bankare.

iv) Pagesat e fazave do të kryhen nëpërmjet një kredie dokumentare të parevokueshme, të patransferueshme që mund të konfirmohet nga Furnizuesi.

v) Kreditë dokumentare do të hapen sipas nenit 14.2.2.

vi) Në rast se Blerësi dështon në hapjen e kredisë dokumentare, brenda periudhës së përcaktuar më sipër, çdo vonesë në hapjen e kredisë dokumentare pas datës së përcaktuar më sipër, do të ketë për pasojë shtyrjen për të njëjtën periudhë vonese kohore të datave të dorëzimit, të përcaktuara në nenin 15.

vii) Nëse kredia dokumentare skadon përpara përfundimit të plotë të dorëzimit të furnizimeve, Blerësi duhet të mundësojë zgjatjen e afatit, me kërkesën dhe shpenzimet e furnizuesit.

viii) Të gjitha pagesat në lidhje me lëshimin e kredisë dokumentare që sjellin në vendin e Blerësit, do të përballohen nga Blerësi dhe të gjitha pagesat që rrjedhin nga vendi i Furnizuesit, do të përballohen nga Furnizuesi, duke përfshirë dhe pagesat e konfirmimit, nëse është e aplikueshme.

ix) Kreditë dokumentare rregullohen sipas praktikës së njësuar doganore dhe praktikës mbi kreditë dokumentare 2007, publikimi I.C.C. nr. 600.

x) Pagesat do të konsiderohen të përmbushura në momentin që shuma e plotë kreditohet në mënyrë të parevokueshme në llogarinë bankare të Furnizuesit, sikurse përmendet më poshtë, me kusht që të gjitha kërkesat e kësaj Kontrate dhe të LC-së të jenë plotësuar siç duhet.

xi) Livrimi i pjesshëm dhe pagesat respektive nëpërmjet LC-së janë të lejueshme.

14.2. Pagesa

14.2.1 Parapagesa

Brenda njëzet (20) ditësh, duke filluar nga miratimi i Kontratës nga Këshilli i Ministrave, Blerësi do t'i paguajë Furnizuesit një parapagesë prej USD 2.226.000 (dy milionë e dyqind e njëzet e gjashtë mijë USD). Kjo pagesë bëhet përkundrejt paraqitjes së faturës për parapagesën të lëshuar nga Furnizuesi, në llogarinë e Furnizuesit të përmendur më poshtë:

CITIBANK N.A.

ABA #021000089

LMGI-VALLEY FORGE COLLECTION CENTRE

A/C #30629125

14.2.2 Pagesa e progresit të punës

Brenda dy muajsh nga T0, Blerësi do t'i paguajë Furnizuesit pagesë për progresin e punës/*site survey* me vlerë USD 1.774.000 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë USD). Kjo pagesë kryhet përkundrejt paraqitjes së faturës së progresit të punës dhe certifikatës korresponduese të progresit të punës të lëshuar nga Furnizuesi.

14.2.3 Pagesa e fazave

Pagesat e fazave do të kryhen nëpërmjet kredisë dokumentare, të pagueshme me plotësimin e fazave të ndryshme, të rëna dakord nga Palët, si vijon:

Kredia e parë dokumentare do të hapet me urdhër të Blerësit, jo më vonë se marsi i 2018-ës, për vlerën prej USD 9.500.000 (nëntë milionë e pesëqind mijë USD), për të mbuluar kohën e nevojshme për përmbushjen e fazave të parashikuara për vitin 2018. Kjo kredi dokumentare do të jetë vlefshme deri më 20 dhjetor 2018. Kredia dokumentare do të jetë në formën e bashkangjitur si aneksi 5 dhe të shqyrtohet dhe të aprovohet nga Furnizuesi përpara lëshimit.

Pagesat përmes kësaj letërkredie do të jenë të pagueshme te Furnizuesi, pas certifikatës së përmbushjes së fazave, kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

- I. Faturës tregtare origjinale plus dy kopje të lëshuara nga *Lockheed Martin Global Incorporated*.
- II. Certifikatës së konformitetit në një origjinale dhe një fotokopje, lëshuar nga *Lockheed Martin Global Incorporated*, për dorëzimin e fazës.
- III. Certifikatës së plotësimit të fazës në origjinal, e nënshkruar nga Blerësi.
- IV. Certifikatës së origjinës së mallit.

Meqenëse Blerësi ka aplikuar parapagesën, fatura komerciale do të ketë vlerën reale të mallit dhe vlerën e saj të pagueshme. Vlera e pagueshme do të jetë vlera e mallit minus vlerën e parapaguar.

Kredia e dytë dokumentare do të hapet me urdhër të Blerësit, jo më vonë se marsi i 2019-ës, për vlerën prej USD 5,639,000 (pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë USD), për të mbuluar kohën e nevojshme për përmbushjen e fazave për vitin 2019. Kjo kredi dokumentare do të jetë vlefshme deri më 20 shtator 2019. Kredia dokumentare do të jetë në formën e bashkangjitur si aneksi 5 dhe të shqyrtohet dhe të aprovohet nga Furnizuesi përpara lëshimit.

Pagesat përmes kësaj letërkredie do të jenë të pagueshme te Furnizuesi, pas certifikatës së përmbushjes së fazave, kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

- I. Faturës tregtare origjinale plus dy kopje të lëshuara nga *Lockheed Martin Global Incorporated*.
- II. Certifikatës së konformitetit në një origjinale dhe një fotokopje, lëshuar nga *Lockheed Martin Global Incorporated*, për dorëzimin e fazës.
- III. Certifikatës së pranimit të fazës në origjinal, e nënshkruar nga Blerësi.
- IV. Certifikatës së origjinës së mallit.

Në rast se kërkohet miratimi i Blerësit për pagesë nga Banka lëshuese e kredisë dokumentare, e kushtëzuar me paraqitjen e dokumenteve të specifikuar në nenin e mësipërm, Blerësi duhet të ofrojë një miratim të tillë në bankën lëshuese të kredisë dokumentare, brenda pesë (5) ditëve nga marrja e kërkesës nga Blerësi.

14.3 Garancitë

14.3.1 Sigurimi i Kontratës

i) Furnizuesi, brenda 15 ditësh nga nënshkrimi i Kontratës nga të dyja Palët do t'i japë Blerësit sigurimin e Kontratës prej 10% të vlerës së projektit (2.226.000 USD).

ii) Vlera e sigurimit të Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Furnizuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas Kontratës.

iii) Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Shitësit jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i zbatimit të Kontratës.

iiii) Tërheqje të pjesshme nga sigurimi i Kontratës janë të lejueshme.

Neni 15

Dorëzimi

15.1 Dorëzimi final do të jetë në Midë, me transportimin përfundimtar (përfshirë sigurimin) dhe instalimin që do të kryhen sipas Kontratës FMS. Dorëzimi i pajisjes sipas kësaj Kontrate do të jetë DAP Durrës, sipas incotermave 2010. Blerësi do të jetë përgjegjës për të shërbyer si importues i mallrave, si dhe përgjegjës për shpenzimet që lidhen me procedurat doganore, përfshirë zhdoganimin e importit, TVSH-në dhe tarifatat doganore.

15.2 Pas dorëzimit të pajisjeve, Blerësi do të inspektojë pajisjet dhe do të njoftojë Furnizuesin, brenda një kohe të arsyeshme, që të mos kalojë 30 ditë nga dorëzimi i ndonjë defekti të dukshëm, dëmtimi, mungesa të pajisjeve ose mospërputhshmërisë. Nëse Blerësi nuk njofton Furnizuesin brenda kësaj periudhe tridhjetë (30) ditësh, Blerësi do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë kundërshtim ndaj pajisjes së tillë dhe çdo pajisje e tillë do të konsiderohet të jetë pranuar nga Blerësi. Përveç nëse parashikohet ndryshe në Kontratë, pranimi është përfundimtar, përveçse për sa u përket defekteve që nuk janë të dukshme në inspektimin vizual. Inspektimi i tillë vizual do të dëshmohet dhe do të vërtetohet nga përfaqësuesit e të dyja Palëve.

15.3 Rreziku i humbjes në lidhje me çdo pajisje do të kalojë te Blerësi në përputhje me Incoterms 2010, të përcaktuar më sipër në nenin 15.1.

15.4 Titulli i pajisjeve do të kalojë te Blerësi menjëherë para dorëzimit nga Furnizuesi, në përputhje me këtë nen. Për shmangien e dyshimit, titulli do të kalojë në të gjitha pajisjet jashtë Shqipërisë.

15.6 Livrimi i hershëm është i lejuar, duke njoftuar tridhjetë (30) ditë përpara Blerësin dhe me pranimin e këtij të fundit.

15.7 Të gjitha pajisjet, objektet, shërbimet ose informatat që do të furnizohen nga Blerësi të jenë të listuara në shtojcën 1, "Qëllimi i punës". Blerësi është përgjegjës për gjendjen e të gjitha pajisjeve dhe objekteve të furnizuara nga Blerësi, duke përfshirë çdo vend në të cilin do të vendoset sistemi TPS-77. Blerësi, gjithashtu, do të jetë përgjegjës për saktësinë e çdo informacioni dhe/ose të dhënave që do të sigurohet nga Blerësi.

15.8 Në rast të humbjes ose të dëmtimit të pronësisë së furnizuar nga Furnizuesi, si rezultat i neglizhencës së vetme të Furnizuesit, Furnizuesi duhet të riparojë ose të zëvendësojë këtë pasuri me shpenzimet e Furnizuesit ose, sipas opsionit të Furnizuesit, t'ia paguajë vlerën e pronës Blerësit.

15.9 Furnizuesi duhet të ofrojë, pas dorëzimit, një kosto ndarëse të pajisjeve të dërguara, për qëllimet administrative dhe llogaridhënese të Blerësit.

15.10 Nëse ndonjë mall do të dorëzohet me origjinë nga Bashkimi Evropian, Furnizuesi duhet të ofrojë certifikatën EUR1, për qëllime doganore.

Neni 16

Forca madhore

Asnjëra nga Palët nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër për ndonjë humbje ose dëmtim të çfarëdo lloji në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, nëse dhe deri në masën që e njëjta është shkaktuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga zjarri, përmytjet, tërmetet, elementet e natyrës, epidemitë, pandemitë, karantina, veprime të Perëndisë, aktet e luftës, terrorizmit, trazirave civile apo grindjet politike, fetare, civile ose ekonomike ose ndonjë shkak tjetër përtej kontrollit të arsyeshëm të Palëve.

Pala e dëmtuar nga një ngjarje e forcës madhore duhet ta njoftojë Palën tjetër për ekzistencën dhe natyrën e një ngjarjeje madhore me shkrim, brenda 15 ditëve nga koha kur ata bëhen të vetëdijshëm ose të bëjnë një përcaktim të ngjarjes së forcës madhore.

Pas pushimit të ngjarjeve të forcës madhore, Palët mund:

- i) të vazhdojnë zbatimin e detyrimeve, në përputhje me kushtet e Kontratës, të përshtatura me rrethanat; ose
- ii) të bien dakord për të përmbushur detyrimet përkatëse, të ndodhura para ngjarjes së forcës madhore, duke e konsideruar pjesën tjetër të Kontratës të zgjidhur në mënyrë të rregullt.

Neni 17

Vonesat e justifikueshme

Çdo shtyrje e datës së dorëzimit nga shkaqet e mëposhtme nuk do të konsiderohet si vonesë në dorëzim që çon në pagesën e dëmeve të likuiduara sipas nenit 25:

- i) ndryshimet ose shtesat në Kontratë, të kërkuara nga Blerësi pas hyrjes në fuqi të Kontratës;
- ii) çdo dështim nga Blerësi për të përmbushur detyrimet në përputhje me këtë Kontratë, si dhënia e certifikatës së përdoruesit të fundit;
- iii) çdo ngjarje force madhore sipas nenit 16.

Neni 18

Inspektimet dhe pranimet

18.1 Sistemi TPS-77 do t'i nënshtrohet testimit të pranimit në fabrikë, në përputhje me shtojcën 1. Kryerja këtyre testeve do të përbëjë pranimin e pjesës së sistemit TPS-77 që testohet (Pranimi). Dokumentet e testimit, duke përfshirë planet e FAT-së dhe të SAT-së, procedurat, matricën e kërkesave (RTM), do të dorëzohen te Blerësi, vetëm për informacionin e Blerësit.

18.2 Furnizuesi do të kryejë të gjitha testimet dhe inspektimet e kërkuara nga procesi i prodhimit teknik gjatë testeve të pranimit në fabrikë. Furnizuesi duhet të njoftojë Blerësin 30 (tridhjetë) ditë para kohës së testeve dhe ta ftojë atë për pjesëmarrje. Nëse Blerësi nuk përgjigjet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit ose nëse Blerësi tregon se nuk do të marrë pjesë në FAT, Furnizuesi do të zhvillojë testimin pa praninë e Blerësit.

18.3 Blerësi, krahas personelit të vet, ka të drejtë të asistohet nga një Palë e tretë deri në tre përfaqësues, të cilët do ta përfaqësojnë ose do t'u shtohen përfaqësuesve të Blerësit. Blerësi dhe/ose Pala e tretë do të dërgojnë të dhënat e nevojshme të personelit të tyre, për qëllime administrative, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga zhvillimi i aktivitetit. Furnizuesi rezervon të drejtën të refuzojë ndonjë ose të gjithë pjesëmarrësit (nga pala e tretë) në rast të konfliktit të justifikuar të interesave, çështjeve të sigurisë ose eksportit. Furnizuesi rekomandon identifikimin e Palës së tretë sa më shpejt që të jetë e mundur për të lehtësuar miratimet e eksportit. Përveç kësaj, çdo Palë e tretë e identifikuar do të nënshkruajë një marrëveshje konfidencialiteti me Furnizuesin përpara se të hyjnë në ambientet e tyre.

18.4 Me përmbushjen e kënaqshme të procedurave të testimit, autoritetet kompetente të Departamentit të Kontrollit të Cilësisë së Furnizuesit do të lëshojnë një dokument që vërteton përputhshmërinë e pajisjes me standardet (Certifikata e përputhshmërisë).

18.5 Furnizuesi është përgjegjës për akomodimin pranë ambienteve të Furnizuesit, transportin lokal në/dhe nga ambientet e tij, vaktet për personelin e Blerësit, që merr pjesë në trajnim, testimin e pranimit të fabrikës dhe takimet e progresit të projektit. Kjo, kostoja, është për një periudhë kohe dhe numrin e pjesëmarrësve, siç është përcaktuar për trajnimin në këtë deklaratë të punës (SOW).

Blerësi dhe/ose Pala e tretë do të përballojnë kostot e tyre të transportit ndërkombëtar, në lidhje me çdo procedurë testimi, trajnimi ose takime.

Nëse procedurat e testimit vonohen për faj të Furnizuesit, Furnizuesi do të mbajë kostot shtesë të arsyeshme të Blerësit (përfshirë akomodimin në vendin e Furnizuesit, në përputhje me praktikat standarde të Furnizuesit, sikurse dhe mjetet lokale të transportit për përfaqësuesit e Blerësit në/dhe nga vendqëndrimi i tyre pas mbërritjes nga vendi i tyre në vendet ku do të zhvillohet FAT).

Në rast të dështimit të testimit të pranimit të fabrikës, për faj të Furnizuesit, shpenzimet për pjesëmarrjen e Blerësit në testet e pasardhshme do të përballohen nga Furnizuesi, në përputhje me dispozitat e nenit 18.5.

18.6 Në rast se Blerësi do t'i kërkojë shitësit të bëjë teste ose inspekte shtesë, të paparashikuara në Kontratë, kostot e këtyre testeve do të përballohen nga Blerësi. Në rast se ky testim ndikon në ecurinë e livrimit të mallit, Blerësi do të bjerë dakord të ndryshojë grafikun e livrimit për atë kohë sa është ndikuar.

18.7 Gjatë mungesave FAT, të cilat nuk ndikojnë materialisht në performancën e sistemit TPS-77 (mangësi estetike), këto mangësitë do të riparohen menjëherë nga Furnizuesi, por nuk do të vonojnë pranimin ose dorëzimin, ose ndonjë pagesë për shoqërimin për fazën. Blerësi dhe Furnizuesi do të bien dakord për një afat të arsyeshëm për riparimin e çdo mangësie estetike.

18.8 Blerësi ka të drejtë të refuzojë çdo pjesë të sistemit TPS-77, i cili rezulton i dëmtuar si rezultat i FAT-së dhe në opsionin e tij, Furnizuesi do të riparojë ose do të zëvendësojë këtë pajisje. Nëse ndonjë mangësi ose defekt material është identifikuar gjatë dhe mbetet për t'u korrigjuar pas FAT-së, një mangësi apo defekti i tillë duhet të dokumentohet dhe dokumenti duhet të nënshkruhet nga të dyja Palët. Furnizuesi pranon që ose të korrigjojë mungesën, ose defektin në 45 ditë pas përfundimit të fazave në fuqi, ose të sigurojë një plan për të korrigjuar këtë mangësi, ose defekti me një datë me të cilën do të përmirësohet defekti ose mangësia.

18.9 Gjatë ndërtimit të ndonjë pune civile, Blerësi ka të drejtën të inspektojë gjatë procesit të ndërtimit. Furnizuesi do të njoftojë Blerësin minimalisht 2 ditë para fillimit të punimeve.

Neni 19

Koha e përmbushjes

19.1 Furnizuesi do të plotësojë detyrimet e tij sipas Kontratës në përputhje me planin në shtojcën 2, "Plani i fazave" (muajt pas hyrjes në fuqi të Kontratës). Çdo datë e përcaktuar në planin e fazave supozohet të jetë dita e fundit e muajit të caktuar. Livrimet e pjesshme do të lejohen, përveç nëse specifikohet ndryshe në planin e fazave.

19.2 Për qëllimin e identifikimit të materialit të transferuar në pronësinë e blerësit para përfundimit të SAT-së, "Pajisja" do të përcaktohet si element i integruar dhe jo i integruar të sistemit TPS-77. Pajisja do të konsiderohet e dorëzuar përfundimisht kur Furnizuesi ka kryer detyrimet e tij në përputhje me afatin e dorëzimit në nenin 15 (Dorëzimi).

19.3 Në kohën e përfundimit të çdo faze (milestone), Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë të përmbushjes së fazës (COMA) për nënshkrim të Blerësit. Nëse Blerësi beson se faza nuk është plotësuar kur Furnizuesi dëshiron të ekzekutojë COMA-n, Blerësi do të deklarojë kundërshtimet e tij me shkrim brenda 20 ditëve nga paraqitja e COMA-s. Nëse Blerësi dështon të paraqesë kundërshtime brenda kësaj periudhe kohore, Blerësi do të ketë hequr dorë nga e drejta e tij për të

ngritur një kundërshtim dhe do të konsiderohet se ka miratuar COMA-n. Në një rast të tillë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të paraqesë COMA-n për pagesë, pa nënshkrimin e Blerësit, me kusht që Furnizuesi gjithashtu të japë një deklaratë me shkrim që tregon se Blerësi ka hequr dorë nga çdo e drejtë për të ngritur një kundërshtim në përputhje me këtë dispozitë.

Neni 20

Furnizimi i mallit sipas cilësisë dhe specifikimeve teknike

20.1 Furnizuesi do të dorëzojë mallrat me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në Kontratë. Mallrat e furnizuara do të jenë konform kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të Kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit me shkrim nga Blerësi.

20.2 Për elementet e bllokut të pajisjeve (LRU) në setin Radar TPS-77, furnizuesi do të sigurojë listën më aktuale të numrave *National NATO Stock Number* në nivelin e LRU.

20.3 Sistemi i radarit do të ketë mundësi në dhe kapacitetin për t'u përmirësuar sipas teknologjive më të reja bashkëkohore të reja të përdorura në këtë fushë.

Neni 21

Ambalazhimi

Furnizuesi do të dorëzojë mallrat/pajisjen të ambalazhuara, në mënyrë të tillë që garantojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit dhe magazinimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 22

Sigurimi i mallit

Sipas incotermit të përcaktuar në nenin 15.1, sigurimi i mallrave është nën përgjegjësinë e vetme dhe në dobi të Furnizuesit. Prandaj Furnizuesi do të regjistrohet në një policat e sigurimit.

Neni 23

Garancia

23.1 Furnizuesi garanton që sistemi TPS-77 do të jetë i lirë nga defektet në material dhe fuqi punëtore për një periudhë 12-mujore që fillon nga nënshkrimi i certifikatës SAT nga Blerësi (Periudha e garancisë).

23.2 Nëse ndonjë defekt i mbuluar nga garancia identifikohet brenda periudhës së garancisë, Blerësi do të njoftojë furnizuesin për ekzistencën dhe natyrën e defektit brenda 72 orëve nga identifikimi i defektit. Me udhëzimet e furnizuesit, Blerësi do të heqë pjesën e dëmtuar dhe do ta kthejë atë me shpenzimet e Furnizuesit sipas udhëzimeve të tij.

23.3 Çmontimi i ndonjë pjese të defekteve nga sistemi dhe dërgesa në ambientet e Furnizuesit është përgjegjësi e Blerësit. Kostoja e transportit do të mbulohet nga Furnizuesi. Transporti i kthimit do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit.

23.4 Furnizuesi do t'i transferojë ose do t'i caktojë Blerësit, në masën e lejuar, ndonjë garanci të dhënë nga furnitorët ose nënkontraktorët e Furnizuesit që vazhdojnë përtej periudhës së garancisë.

23.5 Furnizuesi nuk mund të përdorë rregullat e përcaktuara këtu, nëse defektet që lidhen me faktet njohurive të tij ose nuk mund të ishin të panjohura dhe nuk ishin vërejtur nga Blerësi në kohën kur mallrat ishin dorëzuar te Blerësi.

23.6 Nëse dëmtimi i një blloku zëvendësimi (LRU) që është kritik për operimin e radarit, rezulton në kthimin operacional të radarit, *Lockheed Martin* do të sigurojë një veprim të mirëmbajtjes për

kthimin të sistemit në operacionalitet. Nëse pas një periudhe prej shtatë (7) ditësh radari është ende jooperacional, periudha e garancisë do të zgjatet për çdo ditë që radari mbetet jooperacional deri në një zgjatje maksimale prej gjashtë (6) muajsh.

23.7 Garancia, sipas kësaj Kontrate ka për qëllim të mbulojë dështimet e produktit gjatë periudhës së Garancisë. Marrëveshja e mirëmbajtjes, e përmendur në nenin 30, synon të mbulojë shërbimet e kërkuara për të siguruar disponueshmëri të lartë operationale të sistemit të radarit.

23.8 Korrigjimet e paraqitura në këtë dispozitë garancie janë korrigjimet ekskluzive të Blerësit.

Neni 24

Vonesa në zbatim dhe zgjatjen e afatit

24.1 Furnizuesi do të fillojë nga koha zero (T0) në përputhje me nenin 32.

24.2 Në rast se Furnizuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Shitësi do të njoftojë menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose të përfundimit. Blerësi do të vlerësojë kërkesën. Nëse Blerësi është dakord me vonesën, zgjatja e afatit kohor do të hyjë në fuqi nëpërmjet njoftimit me shkrim të njoftuar nga Blerësi.

Neni 25

Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar

25.1 Me përfundimin e periudhës 1-mujore (njëmujore), dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat ditore prej 1/1000 e vlerës korresponduese të mbetur, nga çmimi total i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

25.2 Blerësi do të njoftojë Furnizuesin mbi deklaratën e detajuar të dëmeve të likuiduara dhe Furnizuesi ka të drejtë të paraqesë komentet e veta për Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit të deklaratës. Blerësi do t'i faturojë shumën korresponduese Furnizuesit dhe Furnizuesi do të paguajë brenda tridhjetë (30) ditëve në llogarinë e përcaktuar të Blerësit.

25.3 Në asnjë rrethanë, shuma e përgjithshme e dëmeve të likuiduara nuk tejkalon 10% të vlerës së Kontratës të mallit të vonuar.

Neni 26

Negociatat dhe amendimet

26.1 Palët do të negociojnë ndryshime ose amendime të elementeve të kësaj Kontrate ose që kanë lidhje të pazgjidhshme me të, vetëm me kërkesën me shkrim të Palëve.

26.2 Asnjë amendim ose variacion tjetër i Kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht Kontratës ose të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Palëve.

26.3 Blerësi rezervon të drejtën të porosisë mallra shtesë deri në një masë që nuk i kalon 20% të çmimit total të Kontratës. Në veçanti, çmimet dhe programi i livrimit të mallrave ose i shërbimeve shtesë, nëse ka, do të bihen dakord ndërmjet Palëve nëpërmjet një amendamenti të kësaj Kontrate.

26.4 Nëse pas datës së nënshkrimit të Kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë bëhet inaktiv, promulgohet ose amendohet, efekti i tij në kushte, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e Kontratës, do të rregullohet në masën që Furnizuesi është i ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës.

Neni 27

Zgjidhja e Kontratës

27.1 Zgjidhja nga Blerësi për faj të Furnizuesit

Blerësi mund ta ndërpresë këtë Kontratë në rast se Furnizuesi, në mënyrë të vazhdueshme, dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij pa ndonjë arsye dhe pavarësisht se Blerësi ka njoftuar me shkrim Furnizuesin për të marrë masa të mjaftueshme rregulluese dhe nëse është vërtetuar se

masa të tilla nuk janë marrë brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas njoftimit të mësipërm të Blerësit. Në raste të tilla do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Furnizuesi do të autorizohet të dorëzojë furnizimet e mbetura, të cilat nuk kanë qenë shkak për mosarritjen e zbatimit të detyrimeve të tij dhe do të paguhet për çmimin përkatës.

b) Blerësi ka të drejtë të mbajë të gjitha ose një pjesë e sigurimit të Kontratës dhe Furnizuesi nuk ka të drejtë për të marrë pagesat për pjesën e Kontratës e cila nuk është kryer.

27.2 Zgjidhja nga Furnizuesi për faj të Blerësit

Furnizuesi mund të zgjidhë pjesërisht ose plotësisht këtë Kontratë, në rast se Blerësi, në mënyrë të vazhdueshme, dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij pa ndonjë arsye, pavarësisht se Furnizuesi ka njoftuar me shkrim Blerësin për të marrë masa të përshtatshme rregulluese dhe nëse është vërtetuar se masa të tilla nuk janë marrë brenda një periudhe prej 30-ditore (tridhjetëditore), pas njoftimit të mësipërm të Furnizuesi. Në raste të tilla do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Mallrat e përfunduara, por ende të padorëzuara në datën e marrjes nga Blerësi të një njoftimi të tillë të zgjidhjes, do të pranohen në zbatim të dispozitave të kësaj Kontrate dhe do të dorëzohen nga Furnizuesi dhe do të paguhet nga Blerësi.

b) Blerësi do të rimbursojë Furnizuesin për të gjitha kostot e hasura nga Furnizuesi ose të cilat Furnizuesi nuk mund t'i shmangete sipas kësaj Kontrate, në mënyrë të veçantë që të gjitha shpenzimet e bëra deri në datën e përfundimit, siç është, por jo kufizuar në shpenzimet e prodhimit, koston e ndërprerjes së kontratave me nënkontraktorët, koston e lëndëve të para, kostove direkte dhe indirekte të punës, koston e prokurimit të përgjithshëm, prodhimit dhe aktiviteteve administrative në lidhje me zbatimin e Kontratës.

27.3 Zgjidhja për shkak të interesit publik

Blerësi mund të zgjidhë Kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik. Blerësi do t'i japë Furnizuesit njoftim me shkrim për zgjidhjen e Kontratës.

Blerësi do të paguajë Furnizuesin për të gjitha mallrat, të cilat ishin dorëzuar para ndërprerjes dhe duhet të paguajë Furnizuesin për dëmet e shkaktuara për zbatimin e pjesshëm. Ndërsa në llogaritjen e vlerës së dëmeve, Furnizuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, për të minimizuar dëmet. Në veçanti, shumat për t'iu paguar Furnizuesit përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra deri në datën e zgjidhjes, siç është por jo kufizuar në, shpenzimet e prodhimit, koston e përfundimit të kontratave me nënkontraktorë, kostoja e lëndëve të para, punës direkte dhe indirekte, kostoja e prokurimeve të përgjithshme, prodhimit dhe aktiviteteve administrative në lidhje me zbatimin e Kontratës.

27.4 Zgjidhja nga Blerësi për shkak të falimentimit të Furnizuesit

Blerësi mund ta zgjidhë Kontratën në çdo kohë, në qoftë se Furnizuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

Blerësi do t'i japë Furnizuesit njoftim me shkrim lidhur me zgjidhjen.

27.5 Ndërprerja prej forcës madhore

Në rast të shfaqjes së një force madhore, e cila zgjat për më shumë se 3 (tre) muaj, Palët do të takohen në mënyrë që të përcaktojnë në cilat kushte ata dëshirojnë të ndjekin Kontratën ose ata mund të vendosin ta zgjidhin Kontratën në përputhje me nenin 27.3 më sipër.

Pas shlyerjes së detyrimeve të Furnizuesit nga Blerësi, nëse ka ndonjë, Blerësi menjëherë do të kthejë sigurimin e Kontratës në bankën lëshuese për anulim.

Neni 28

Publikimet teknike dhe trajnimi

28.1 Furnizuesi do të ofrojë pa kosto shtesë publikimet teknike për përdorimin dhe mirëmbajtjen

e sistemit, objekt i kësaj Kontrate, në anglisht.

28.2 Për çdo trajnim të kryer nga Furnizuesi për Blerësin në ambientet e Furnizuesit, Blerësi do t'i sigurojë Furnizuesit një listë të emrave të pjesëmarrësve të caktuar, së paku 30 ditë para mbërritjes së tyre në ambientet e Furnizuesit në *Syracuse*, Nju-Jork.

Blerësi do të jetë përgjegjës për marrjen e vizave të duhura hyrëse nga ambasada ose konsullata e SHBA-së, emigracioni dhe autorizime të tjera për çdo pjesëmarrës para mbërritjes në Shtetet e Bashkuara. Furnizuesi do të sigurojë një ftesë zyrtare për ambasadën lokale të SHBA-së dhe Blerësin për lëshimin e vizave.

Furnizuesi rezervon të drejtën të refuzojë hyrjen ose të heqë një pjesëmarrës nga pjesëmarrja në ndonjë kurs trajnimi në rast se pjesëmarrësi i tillë dështon ose të përmbushë ligjin e SHBA-së (federale, shtetërore ose lokale) ose me politikën e *Lockheed Martin*.

Neni 29

Zëvendësimi i Palëve

29.1 Furnizuesi rezervon të drejtën të zëvendësojë pjesë të zgjedhura dhe/ose pajisje me pjesë të tjera dhe/ose pajisje me kapacitete funksionale të njëjta ose më të larta që nuk ndikojnë negativisht në formën, përshtatjen ose funksionimin e pajisjes.

29.2 Pas përcaktimit nga Furnizuesi se një proces dhe/ose komponent i nevojshëm në prodhimin, testimin ose dorëzimin e ndonjë pjese të pajisjes, të kërkuara nga sistemi TPS-77, nuk është i disponueshëm për shkak të vjetërsisë ose burimeve të reduktuara të prodhimit, Furnizuesi do të ruajë të drejtën për të kryer një zëvendësim të përshtatshëm dhe ndonjë rritje e mundshme e kostos për zëvendësimin do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Një zëvendësim i përshtatshëm përfshin çdo pajisje që siguron të njëjtin funksion sikurse realizohet nga pjesa e përcaktuar fillimisht dhe është përcaktuar të jetë me cilësi të ngjashme ose më të mirë. Blerësi do të informohet përkatësisht.

Neni 30

Detyrime të postinstalimit

Jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të Kontratës, Palët do të takohen për të diskutuar mbi Marrëveshjen e mirëmbajtjes, për të përfshirë, por pa u kufizuar, në pjesë këmbimi, riparime dhe trajnime. Një marrëveshje e tillë e ardhshme do të jetë subjekt i kushteve të pranueshme reciprokisht. Palët do të përpiqen që të kenë një marrëveshje të tillë para përfundimit të testit të pranimi të vendit.

Neni 31

Përgjegjësitë

Është rënë dakord shprehimisht se përgjegjësia e Furnizuesit do të kufizohet në dëmshpërblim për dëmin material të drejtpërdrejtë dhe të parashikueshëm, për shkak të një gabimi që i atribuohet Furnizuesit, i cili është vërtetuar nga Blerësi, me përjashtim të çdo dëmtimi apo shpenzimi pasues, të rastësishëm, ndëshkues të çdo lloji dhe natyre dhe/ose ndonjë humbje të fitimit, humbjes së përdorimit të mallrave, kostove shtesë, humbjes së shitjeve, biznesit dhe/ose vetëdijes së markës. Blerësi do të zbusë dëmin e tij, duke marrë të gjitha masat e nevojshme.

Detyrimi i Furnizuesit sipas Kontratës për çfarëdolloj arsyeje do të kufizohet në pesëdhjetë për qind (50%) të çmimit të Kontratës. Kufizimi i tillë do të jetë i zbatueshëm dhe i detyrueshëm për Palët, pavarësisht nga fakti se Palët mund të përdorin dispozitat e arbitrazhit.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Të gjitha termat dhe kushtet e përcaktuar këtu janë miratuar dhe pranuar nga të dyja Palët.

Hyrja në fuqi e Kontratës i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

- Nënshkrimi i Kontratës nga të dyja Palët;
- Lëshimi i sigurimit të Kontratës sipas nenit 14.3.1;
- Ratifikimi i Kontratës nga Këshilli i Ministrave.

Furnizuesi do të lëshojë një dokument T0, ku thuhet se kushtet e sipërcituara janë përmbushur dhe Furnizuesi ka marrë parapagesën, siç parashikohet në nenin 14.2.1, në datën T0.

Kjo Kontratë përfshin: “Parathënien”, “Kushtet e përgjithshme”, “Kushtet e veçanta” dhe “Shtojcat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9”, bashkëlidhur kësaj Kontrate. Kontrata në total përmban 329 (treqind e njëzet e nëntë) fletë.

Kontrata është përpiluar në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, në 4 kopje për secilën gjuhë (një kopje në anglisht dhe shqip për Furnizuesin dhe tri kopje në anglisht dhe shqip për Blerësin).

Nënshkruar në Ministrinë e Mbrojtjes, në shtator 2017.

BLERËSI

Zonja Olta Xhaçka

Ministër i Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes e RSH-së

FURNIZUESI

Mr. Christopher Bowman

Lockheed Martin Global Incorporated